

FJALA E DEPUTETES ALBANA VOKSHI

E ENJTE 10 NËNTOR 2022

Të nderuar qytetarë,

Kolegë,

Diskutimi i buxhetit të shtetit është ngjarja më e rëndësishme në një vit parlamentar, është i rëndësishëm për Kuvendin, por kryesisht për të gjithë shqiptarët dhe familjet e tyre, ndaj jam e sigurt që çdo qytetar, që e kishte këtë mundësi dje dhe sot, ka qenë përpara televizorit për të dëgjuar Kryeministrin t'i fliste për paketën fiskale; për planin e qeverisë për arsimimin e fëmijëve; për fondet e kurave dhe të ilaçeve të pacientëve; për çmimin e energjisë; për ndihmën ekonomike; për mbështetjen e pensionistëve dhe të personave me aftësi të kufizuar; për planin e mbajtjes së të rinjve në vend; për mirërritjen e fëmijëve; për skemat e subvencionimit të bujqësisë; për arsimin e lartë, për shkencën dhe për inovacionin, që tashmë janë fshirë nga fjalori i kësaj qeverie. Por çfarë dëgjuan shqiptarët dje nga Kryeministri? Fyerje, sharje, nënçmime, kërcënime, mallkime. Nuk besoj se ka vend tjetër në botë, ku Kryeministri të flasë me atë gjuhë të çartur në një foltore parlamenti. Është skandaloze dhe e turpshme!

Si deputete, ndihem e turpëruar kur dëgjoj një fjalor të tillë në këtë sallë, si prind jam e zemëruar që ai njeri lejohet të përdorë këtë gjuhë në këtë foltore që, në fakt, duhet të ishte e shenjtë, sepse duhet të përfaqësojë interesat e çdo qytetari shqiptar. Por Edi Rama ia doli të tërheqë vëmendjen përsëri.

Nuk e di sesa dëgjuan apo lexuan shqiptarët në mediet vizive apo të shkruara rreth buxhetit. Kudo shiheshin tituj bombastikë: “Edi Rama kërcënon opozitën”; “Nga delet te bedelët, nga llaxorët te këlyshët, të pafetë” e të tjera. Të gjitha mediet ishin të mbushura me këta tituj dhe thujse asgjë për buxhetin, thujse asgjë ku do të shkonin paratë e taksapaguesve shqiptarë, ndërkohë që nga goja e Kryeministrit përgjatë 47 minutave dilnin batore sharjesh: “Jeni bedela”, “Jeni kryebedela”, “Bedelë pasionantë”, “Nuk keni atdhe, nuk keni dije, nuk keni imam, nuk keni flamurë, nuk keni asgjë”, “Bartës mallkimi që nga viti 1912”, “Krijesa që mbartni mallkimin” e të tjera. Qindra mijëra njerëz prisnin se ç’do të bëhej me jetën e tyre, me familjet dhe me fëmijët e tyre. Në vend të buxhetit, arsimit, ndihmës ekonomike, shëndetësisë dhe energjisë, shqiptarët dëgjuan gjuhën e dhunshme verbale ndaj kujt do që mendon ndryshe, ndaj kujt do që e kritikon. A i keni parë shifrat e dhunës në Shqipëri? Janë të frikshme! Ja ku e keni njërin prej arsyeve! Në këtë sallë parlamenti gjendet kryedhunuesi verbal, psikologjik dhe

institucional. Në këtë sallë parlamenti keni nxitësin kryesor të dhunës me bazë gjinore dhe me bazë politike.

Ju do të thoni se edhe unë rashë pre e kurthit të Edi Ramës dhe nuk po flas për buxhetin, por, në fakt, po flas për dhunën e Kryeministrit. Pra, ia ka dalë, ia ka arritur qëllimit që të merremi me të, për të mbuluar buxhetin që vidhet apo për të mbuluar aferën skandaloze të portit të Durrësit. Këtë po e bëj për një arsye të vetme: unë distancohem nga ajo gjuhë e dhunshme verbale e Kryeministrit! Çdo deputet në këtë sallë duhet të distancohet nga gjuha e dhunshme, poshtëruese dhe fyese.

I bëj thirrje Kryetares së Kuvendit ta ndalë Kryeministrin kur përdor atë lloj gjuhe! Çdo grua deputete që ka fëmijë, të cilët dëgjojnë në shtëpi, duhet të distancohet sot, çdo deputet prind duhet të distancohet sot nga gjuha e Kryeministrit! Aleanca e Grave Deputete duhet të reagojë menjëherë! Nuk është çështje politike, por është rrezik për fëmijët, është rrezik për familjet shqiptare. Gjuha e Edi Ramës, e pangjashme me asnjë tjetër në botë, është gjuhë e rrezikshme. Nuk është çështje etike, por është çështje dhune, është nxitje dhune, dhe toleranca që i bëhet atij në këtë Kuvend është e pafalshme.

Si deputete dhe si nënë, sa herë që Kryeministri të përdorë këtë lloj gjuhe, unë do të çohem në mënyrë demonstrative për ta lënë këtë sallë. Ftoj të gjitha gratë deputete ta lënë këtë sallë sa herë që ai do të guxojë ta përdorë atë gjuhë! Ftoj mediet të distancohen dhe ta bojkotojnë Edi Ramën sa herë përdor fjalor banal rruge dhe bën si i fortë! Ftoj të mos e botojnë atë për ca klikime më shumë! E përsëris, kjo nuk është çështje etike, por, në këtë rast, mediet do t'u bënin një nder familjeve dhe shoqërisë.

Dje dëgjuam një gjuhë plot mallkime, por mallkimi i vetëm për këtë vend është vetëm një njeri, ai është Edi Rama, është etja e tij e pangopur për pushtet dhe për para. Ky është mallkimi i shqiptarëve, që po i largon ata nga vendi dhe po e shpopullon atë; ky është mallkimi që ka rrënuar arsimin dhe ka shkatërruar shëndetësinë; ky është mallkimi që po e varfëron më shumë vendin dhe po i lë qytetarët pa asnjë shërbim, sepse po qeverisen nga një bandë hajdutësh; ky është mallkimi që i rrit fëmijët pa buzëqeshje dhe i lë të rinjtë pa të ardhme; ky është mallkimi që po i lë shqiptarët pa shpresë, sepse po rivendos një regjim, i cili po shkel çdo ditë të drejtat dhe liritë.

Të dashur qytetarë që po na ndiqni,

Këto 2 ditë duhet të diskutonim buxhetin e shtetit dhe që tani po e them se jam kundër këtij buxheti. Vota ime shkon kundër këtij buxheti, që është si vetë qeverisja, e qepur për t'iu shërbyer pushtetarëve dhe jo qytetarëve. Mjafton t'u referohemi... Ju lutem, zonja Kryetare, ndërkohë që po diskutojmë, po

bëhet pazar! Ju lutem! Zonjë, ka mundësi të mbani pak qetësi?! Mjafton t'u referohemi 2 sektorëve kyç: shëndetësisë dhe arsimit. Sektori i shëndetësisë, nga 3,5 ka shkuar në 3,1. Paratë e shëndetësisë... Ju lutem, mos flisni nga vendi! Merreni më pas fjalën! Paratë e shëndetësisë shkojnë në PPP-të e klientëve të qeveritarëve. Edhe arsimit është në nivelet më të ulëta, 2,3%. Ky buxhet tregon fare qartë arrogancën, inatin, urrejtjen e Kryeministrit ndaj mësuesve dhe pedagogëve, urrejtjen ndaj elitës së kombit, urrejtjen ndaj arsimimit dhe dijeve.

Të dashur qytetarë,

Sot dua t'ju tregoj 2 histori reale, të prekshme, thuajse, nga çdo familje shqiptare.

Pak ditë më parë takova Meremen, djali i së cilës kishte ikur me gomone në Londër dhe për këtë kishte paguar 7 mijë paund. Kishte mbaruar shkollën, por ishte pa punë dhe, sigurisht, paratë i kishte marrë borxh. A ka mallkim më të madh për një të ri të edukuar sesa të rrijë pa punë? Qeveria nuk do t'ia dijë për vende të reja pune, për stazhe dhe projekte për të rinjtë. A ka mallkim më të madhe sesa të qeverisesh nga një i paditur apo nga ata që e urrejnë dijen dhe njerëzit e ditur? A ka mallkim më të madh për një vend, kur Kryeministri mbyll 600 shkolla për 9 vjet, mes tyre edhe shkolla me vlerë historike? A ka fatkeqësi më të madhe për këtë vend sesa një Kryeministër, i cili në një akt total vasaliteti, akt taliban, urdhëron 2 ministre për mbylljen e një gjimnazi dhe një kopshti me 225 fëmijë? Një shkollë e mbyllur nga qeveria për përfitime politike është një orë e zezë për Shqipërinë, është mallkim për të. A ka mallkim më të madh sesa një Kryeministër, i cili jo vetëm nuk e ka prioritet shëndetësinë, por ka shkatërruar çdo shtyllë të saj? Edhe buxheti i shëndetësisë për vitin 2023 shkon për koncesione, për miqtë dhe për sponsorët e Kryeministrit. Një Kryeministër dhe një ministre në kulmin e pandemisë bëjnë tenderë sekretë, për të vjedhur nga paratë e monitorëve, të respiratorëve, të maskave, të veshjeve mbrojtëse, madje edhe të letrave higjienike. Pra, këtu do të shkojnë edhe paratë e sektorit të shëndetësisë për vitin 2023. A ka fatkeqësi më të madhe sesa një Kryeministër që i lë të gjitha nënat kryefamiljare pa para?

Bukuria merr vetëm 33 mijë lekë, me të cilat nuk mund të blejë as bukën. Vera është e papunë, ndërkohë që djali i saj ka një sëmundje në kokë dhe burri i përndiqet çdo ditë nga patronazhistët. Ajo nuk ka para për ta kuruar djalin jashtë dhe për t'i kryer operacionin e duhur. Është edhe rasti i Tanushit, i cili vuan nga skleroza multiple dhe nuk merr dot kurën e përshtatshme, sepse ministrja nuk ia ka siguruar këtë kurë. Vetëm 7% e pacientëve e marrin kurën e duhur, kurse të tjerët janë të destinuar të

shkojnë drejt paralizës. Kush më shumë dhe kush më pak, po hasim përditë histori të tilla. Si ky buxhet, pa asnjë paketë antikrizë, do të ketë edhe të tjerë më të këqij, nëse nuk e ngremë zërin.

Të shtunën, më 12 nëntor, Partia Demokratike ka bërë thirrje për një protestë kombëtare, për të bërë bashkë çdo shqiptar që beson se Shqipërisë i duhet hequr ky mallkim, se Shqipëria meriton shumë më mirë. Protesta e 12 nëntorit na e jep mundësinë të gjithëve, që zëri ynë të dëgjohet. Edi Rama njih vetëm një gjuhë, atë të protestës.

Të shtunën, në datën 12 nëntor, në orën 16:00 të bëhemi të gjithë bashkë për t'u dhënë fëmijëve tanë shpresën se Shqipëria mund dhe do të bëhet! Faleminderit!